



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KËLCYRË
SEKTORI I BURIMEVE NJERWZORE, SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH-së

Nr. 1447 Prot

Këlcyrë, më 03/06/2026

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Për pranimin ne Shërbimin MZSH-së (Sektori për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi), Bashkia Këlcyrë.

Në zbatim të Ligjit Nr 152, datë 21. 12. 2015, "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", Kreu III, neni 14/1 "pranimi në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së" dhe neni 15, Shkresa nr.493 Prot. Dt.25.01.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të Punëve të Brendshme "Mbi përzgjedhjen e aplikantëve për punonjës të shërbimit të shërbimit të MZSH-së për nivelin bazë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.294 dt 05.04.2017 "Për miratimin e listës së bashkive të cilat do të ngrënë stacione të Shërbimit të MZSH-së", Bashkia Këlcyrë njofton se në sektorin e MZSH-së shpallet:

1 (Një) vendë të lirë pune ne nivelin bazë të ketij shërbimi.

1. Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i M.Z.SH.-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. zjarrfikës, operues, luftues dhe drejtues automjeteve zjarrfikëse është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të M.Z.SH.-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njohë dhe të zbatojë orarin e veprimeve, të dijë pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në çdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njohë dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjediseve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë dhe me kolegët e tij.

1.1 Kërkesat e përgjithshme për pranimin,niveli bazë

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- c) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar,
- ç) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucionet e tjera të administratës publike;
- d) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
- dh) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e) Të mos ketë rekorde kriminale në organet e policisë dhe prokurorisë (vërtetim personaliteti nga organet e policisë dhe prokurorisë);
- e) Të jetë i/e moshës nën 30 (tridhjetë) vjeç;
- f) Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë ose në qendra të trajnimit zjarrfikës;
- g) Të jetë me vendbanim sa më pranë stacionit të M.Z.SH.-së;
- gj) Për gjininë mashkullore personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 170 (njëqind e shtatëdhjetë) cm;
- h) Për gjininë femërore, personi duhet të jetë me gjatësi jo më pak se 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) cm;
- i) Të jetë me peshë trupore që t'i përgjigjet raportit të gjatësisë;
- j) Të jetë i pajisur me dëshmi të aftësisë së drejtimit të automjetit të grupit "C";
- k) Kanë prioritet kandidatët që zotërojnë profesione si mekanik, shofer, hidraulik, marangoz, infermier, elektrikist etj.

1.2 Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.

Kandidatët duhet të dërgojnë me postë ose dorazi,në Zyrën e Protokoll-Arkivës, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Këlcyre dokumentat si më poshtë:

- 1.Kërkesë me shkrim drejtuar Institucionit të Bashkisë (Sektorit të Shërbimit të MZSH-së)
2. Formular aplikimi.(Plotësimi i të cilit bëhet pranë zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Bashkia Këlcyre) për pranim në shërbimin e M.Z.SH.-së;

3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Dokument zyrtar që vërteton përfundimin e arsimit,
5. Çertifikatë familjare;
- 6 Jetëshkrimi i plotësuar (CV)
7. Fotokopje dëftesë pjekurie;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton "gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar";
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetim i gjendjes Gjyqësore (Dëshmi Penaliteti), Formular vetëdeklarimi;
12. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
13. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
- 14.2 (dy) copë fotografi (2.5 x 3.5 cm). Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme të sipërcituara

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet nga kandidatët deri ne datën **25.06.2026**

Në datën **26.06.2026**, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht (me email) për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse, Brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje Brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi.

-Testi me shkrim:

Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë

Ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Ligjin nr. 152, datë 21.12.2015,,Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

-Testi Fizik:

-Pompa mbi krahë palosje-shpalosje,kërcim tarabole, vrapim

-Intervista me gojë:

Prezantimi i vetes, aftësia e të komunikuarit, aftësia e të shprehurit.

Intervistat do të zhvillohen në mjediset e Bashkisë Këlcyrë-Salla e Mbledhjeve.

Kandidatët do të vlerësohen nga "Komisioni i Vlerësimit" i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për këtë qëllim.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100 pikë, të cilat ndahen pëkatësisht: 50 (pesëdhjetë) pikë për testimin me shkrim, duhet të kaloj testin fizik dhe 50 (pesëdhjetë) pikë për intervistë me gojë.

Lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur fitues do të shpallet në faqen zyrtare të Bashkisë Këlcyrë dhe në stendën e informimit të publikut.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në njësinë përgjegjëse. Brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje. Brenda 5 diteve pune nga data e depozitimit të saj. Për sqarime, mund të kontaktoni me Sektori i Burimeve Njerëzore në adresën: Bashkia Këlcyrë.

Shpallja është e hapur për të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përgjithshme të sipërcituara. Kandidati fitues do të shpallet aplikanti i renditur me pikët më të larta dhe mbi 60 pikë.

KRYETARI I BASHKISË
Klement NDONI

